

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/Protestat, Rama nga OKB-ja: U fabrikua një narrativë për 'pushtimin izraelit' të bregdetit shqiptar, qytetarët protestuan kundër një fantazme
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/protestat-ne-tirane-rama-nga-okb-ja-u-fabrikua-nje-n-arrative-per-pushti-i588410
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 17:52:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 17:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fa5d5ff50677ba152a9fc8dce146f8cbda2ad8e6c499b718ad3c0213d4a6aa71
TEKSTI	cc0ec02b2375ab48a74c71fafd8991446cea769793209ea572daa17e9bd46669
PAMJA	742ffe459b685798e6041e5ab8ada19aa94bc5198ecd2f620fd3eae638b084f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3356f3cd9a18e53d55b773eefe4eb576fa4ca0079a477ad39b7d0bf63b93ea8b
E MËPARSHMJA	17e321911fcb23de916efbfc0030848a67add6fa66757da0edf4cf47f18b9fe
RRËNJA MERKLE	b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/3356f3cd9a18e53d55b773eefe4eb576fa4ca0079a477ad39b7d0bf63b93ea8b

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)


English

1 e 20 vite UET/ Nga nje ide, ne nje histori qe vazhdonBill Gates: Inteligjenca artificiale mund te shkaktoje vdekjen e nje miliard njerezveRama ne OKB: Shqiperia po nderton fundit

VIDEO/Protestat, Rama nga OKB-ja: U fabrikua një narrativë për ‘pushtimin izraelit’ të bregdetit shqiptar, qytetarët protestuan kundër një fantazme



25 Shtator 2026, 19:50Politika TEMA




Duke folur për rrezikun nga Inteligjenca Artificiale, kryeministri Edi Rama u ndal edhe te protestat në Tiranë, duke iu referuar një imazhi të përhapur në rrjetet sociale.

Në të shfaqej një gardh me tela me gjemba dhe një tabelë që e paraqiste zonën e Zvërnecit si një kufi mes Shqipërisë dhe Izraelit, shoqëruar me flamujt e dy vendeve.

Rama tha se mbi këtë imazh u ndërtua një narrativë e rreme për një “pushtim izraelit” të bregdetit shqiptar, e cila sipas tij u përhap në rrjet dhe nixiti protesta kundër një “fantazme”.

“Jam i bindur se ju e keni ndjekur revolucionin e flamingove, një narrativë e fabrikuar për pushtimin izraelit të bregdetit shqiptar, një pushtim që s’ka ndodhur kurrë, por kjo u fabrikua dhe u përcoll përmes zërave, faqeve dhe kanaleve. Qytetarët i kanë besuar tashmë. Qytetari mori një histori të tradhtisë kombëtare, një tjetër të provokimit fetar, një tjetër për një pushtim të jashtëm. Fabrikime të ndryshme u futën në botë të ndryshme emocionale dhe të gjitha i shërbenin gënjeshtërs strategjike. Pasojat ishin reale. Qytetarët kishin arsyt për të protestuar, por ata papritur ishin duke protestuar kundër një fantazme tashmë. Frika u bë zemërim, zemërimi u bë mobilizim dhe fabrikimi u bë realitet.

Nuk ishte eksperiment, nuk po ju flas për film. Ishte një e martë në Tiranë. Algoritmi nuk shpiku objektivin, këtë e bëri një aktor njerëzor. Ky është mashtrim sistematik. Ndërhyrja në zgjedhje nuk kërkon më që një TV publik apo një propagandë t’i drejtohet një popullate të tërë. Tashmë mund të ndikojë te vullneti i çdo votuesi”, tha Rama.





Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rama në OKB: Inteligjenca artificiale mund të fabrikojë realitetin sipas frikërave të qytetarëve](#)

19:42 Politika

[Sulmi me vezë i protestuesve ndaj Ramës, Balla: Emrat e tyre lidhen me histori shtëpish bari, u bëjnë hyzmet atyre që i paguajnë](#)

19:15 Politika / 11 komente

[Rama publikon foto pak para fjalimit në OKB, Kryeministri pranë flamurit shqiptar](#)

18:55 Politika / 7 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.